

Research article Case study

© 2019 Myzafer Elezi.

This is an open access article licensed under the Creative Commons Attribution-Non-Commercial NoDerivs License ([Creative Commons Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/))

REFLEKTIMI I KRIZËS EKONOMIKE MBI FENOMENET NEGATIVE SHOQËRORE, DHUNA NË FAMILJE NË RAJONIN E VLORËS

Prof.Asc.Myzafer ELEZI
University College “Reald, Albania
myzafer.elezi@unireald.edu.al

Abstract

Domestic violence is not a case, but it is a phenomenon, the geography of which is as much as the entire surface of the planet. From one country to another, both in developing and more developed countries, domestic violence is a present phenomenon. The forms of its manifestation change, and so does the concept, the perception of the abuser and the abused. It also changes the legal way of classifying the act of domestic violence and further punishing the perpetrators of domestic violence.

Domestic violence is presented as a state of repeated victimization, where the victim shares the house with her abuser. Identifying victims of domestic violence presents difficulties. In most cases violence takes place in the home and the victim may be spouses, one of them, children, parents or other blood relatives. In most cases the causes of domestic violence stem from the low economic level, the inability of parents to provide sufficient financial income to lead a normal life, but there are other causes which are related to the profile of the abuser.

The right to freedom, to be safe and equal in the family and society is provided in Article 18 of the Constitution of Albania. While the mutual rights and obligations of spouses and other family members are provided in the Family Code. While in the Criminal Code there is a chapter

which refers to acts against life and health, committed intentionally, intentionally, or negligently. One of the priorities of law enforcement agencies should be to reduce the phenomenon of domestic violence through legal measures and continuous training of structures that handle and investigate these cases. In this context, Albania has ratified a series of international conventions against domestic violence, which have been implemented in domestic legislation.

The object of this paper is to address the causes of domestic violence, the motivating factors that cause it and the actions that must be taken to prevent this phenomenon. To address this phenomenon will be analyzed data obtained from different citizens through a survey, and will use the method of analysis of its motivating factors, types of violence (physical, emotional, economic and sexual, as well as forms others of intimidation, isolation and coercion), in different strata of society regardless of age, education, religion, sex and economic status.

This article aims to bring a reflection of domestic violence in the district of Vlora in recent years. Also, a statistical analysis of the registered criminal offenses will be presented, as well as an analysis of the profile of the raped victim and the perpetrator. The paper will close with some findings and recommendations which aim to reduce the phenomenon of domestic violence through legal measures and ongoing training of structures that handle and investigate these cases.

Key words: *domestic violence, discrimination, victim, family relationship, legal process, etc.*

Abstrakt

Dhuna në familje nuk është një rast, por është një fenomen, gjeografia e të cilit është sa e gjithë sipërfaqja e planetit. Nga njëri vend në tjetrin, si nga ato që janë në zhvillim edhe në vendet më të zhvilluara, dhuna në familje është një dukuri prezentë. Format e shfaqjes së saj ndryshojnë, dhe po ashtu ndryshon edhe koncepti, perceptimi për dhunuesin dhe të dhunuarin.

Gjithashtu, ndryshon edhe mënyra ligjore për klasifikimin e veprës së dhunës në familje dhe më tej për ndëshkimin e autorëve të dhunës në familje. Në familje dhuna paraqitet si gjendje e viktimizimit të përsëritur, ku viktimat ndan shtëpinë me dhunuesin e saj. Identifikimi i viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare paraqet vështirësi. Në shumicën e rasteve dhuna ndodh në banesë dhe viktimë mund të jenë bashkëshortët, njeri prej tyre, fëmijët, prindërit apo persona të tjerë në lidhje gjaku. Në shumicën e rasteve shkaqet e dhunës në familje burojnë nga niveli i ulët ekonomik, pamundësia e prindërve për të siguruar të ardhura financiare të mjaftueshme për të bërë një jetë normale, por ka edhe shkaqe të tjera të cilat lidhen me profilin e dhunuesit.

E drejta e lirisë, të qenit të sigurt dhe të barabartë në familje dhe shoqëri parashikohet

në nenin 18 të Kushtetutës së Shqipërisë. Ndërsa të drejtat dhe detyrimet reciproke të bashkëshortëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes parashikohen në Kodin e Familjes. Ndërsa në Kodin Penal është një kapitull i cili i referohet veprave kundër jetës dhe shëndetit, të kryera me dashje, me paramendim, apo nga pakujdesia. Një ndër prioritetet Reflektimi i krizës ekonomike mbi fenomenet negative shoqërore.

Dhuna në familje në rajonin e Vlorës e organeve të zbatimit të ligjit duhet të jetë reduktimi i fenomenit të dhunës në familje nëpërmjet masave ligjore dhe trajnimit të vazhdueshëm të strukturave që trajtojnë dhe hetojnë këto raste. Në këtë kontekst, Shqipëria ka ratifikuar një serë konventash ndërkombëtare kundër dhunës në familje, të cilat janë implementuar në legjislacionin e brendshëm.

Objekt i këtij punimi është trajtimi i shkaqeve të dhunës në familje, faktorët nxitës që e shkaktojnë dhe veprimet që duhet të ndërmerren për parandalimin e këtij fenomeni. Për trajtimin e këtij fenomeni do të analizohen të dhënat e marra nga qytetarë të ndryshëm nëpërmjet një anketimi, si dhe do përdoret metoda e analizës së faktorëve nxitës të saj, llojet e dhunës së ushtruar (fizike, emocionale, ekonomike dhe seksuale, si dhe format e tjera të frikësimit, izolimit dhe shtrëngimit), në shtresa të ndryshme të shoqërisë pavarësisht moshës, arsimit, fesë, seksit dhe gjendjes ekonomike.

Ky artikull synon të sjelli një pasqyrim të dhunës në familje në rrethin e Vlorës gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, do të paraqitet dhe një analizë statistikore e veprave penale të regjistruara, si dhe analizë të profilit të viktimës së dhunuar dhe dhunuesit. Punimi do të mbyllet me disa gjetje dhe rekomandime të cilat synojnë reduktimi i fenomenit të dhunës në familje nëpërmjet masave ligjore dhe trajnimit të vazhdueshëm të strukturave që trajtojnë dhe hetojnë këto raste.

Fjalët kyçe: *dhunë familjare, diskriminim, viktimë, marrëdhënie familjare, proces ligjor, etj*

1. HYRJE

Dhuna në familje është një fenomen i përhapur në shoqërinë tonë. Ndodh mes partnerëve të ngushtë dhe ndodh në familje. Ndodh në të gjitha klasat shoqërore, pavarësisht moshës, arsimit, fesë, gjendjes ekonomike, etnisë, ose identitetit kulturor.¹ Dhuna në familje ndaj grave nuk është dukuri e re në Shqipëri; ajo i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale (p.sh., rolet dhe identitetet e ngurta gjinore, autoriteti patriarkal, respektimi i kodit të nderit dhe turpit, dhe kontrolli i disa brezave brenda familjes) që prej kohësh i kanë dhënë formë shoqërisë shqiptare.²

Duke u bazuar në vlerat universale të familjes, Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon dhunën në familje si një akt që rezulton, ose ka shumë mundësi të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, shtrëngimet

¹ OSCE: Manual, “Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje”, 2013, faqe 6

² Dhuna në familje në Shqipëri: “Vrojtim kombëtar me bazë popullatën”, 2013 faqe 9.

ose heqjen arbitrare të lirisë.³ Dhuna e burrave ndaj grave në përgjithësi karakterizohet nga privatësia, që do të thotë se tenton të shmangë vëzhguesit e jashtëm.⁴ Dhuna shfaqet në format psikologjike, seksuale, ekonomike dhe fizike.

Në legjislacionin shqiptar janë bërë disa herë ndërhyrje për çështjen e lirisë dhe dhunës në familje. Kushtetuta⁵ sanksionon ndër të tjera se, të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Gjithashtu, në këtë kontekst është miratuar Ligji nr.9669, datë 18 dhjetor 2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjet nr. 9914, datë 12 maj 2008 dhe nr. 10329, datë 30 shtator 2010. Qëllimi i këtij ligji ishte për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje duke përcaktuar masat ligjore ndëshkuese sipas llojit të dhunës në familje.

Gjithashtu, aspekt i rëndësishëm i ligjit është edhe fokusimi tek masat ligjore për marrjen në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje duke marrë në konsideratë kategoritë apo grupet sociale të cilës viktimat i përket.

Ligji përcakton se dhunë në familje quhet çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.

2. ECURIA E VEPRAVE PENALE TË DHUNËS NË FAMILJE NË SHQIPËRI

Pesha specifike që zë grupi i veprave penale kundër fëmijëve martesës dhe familjes për vitin 2015 përkundrajt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 4% ndërsa për vitin 2014 ka qenë 3.8% duke evidentuar trendin rritës të këtij grupi veprash penale.⁶ Në vitin 2014 në shkallë vendi janë regjistruar 1215 procedime penale, nga të cilat janë çuar për gjykim 941, ndërsa në vitin 2013 janë regjistruar 1206 vepra penale të dhunës në familje nga të cilat janë çuar për gjykim 1023.

Në shkallë vendi dhuna në familje zë vendin kryesor në grupin e veprave penale “vepra penale kundër fëmijëve”. Numri i veprave penale të dhunës në familje ka ardhur në rritje. Konkretisht, sipas të dhënave të regjistrimit të veprave penale në Prokurori, rezulton se nga 328 procedime të regjistruara në vitin 2012, numri i procedimeve është rritur në 826 në vitin 2013, 1215 në vitin 2014, dhe 1206 në vitin 2015

3. ECURIA E DHUNËS NË FAMILJE NË VLORË

Në Prokurorinë e Shkallës së Parë Vlorë për vitin 2015 në total janë regjistruar 2385

³ Aleanca Gjimore për Zhvillim “*Dhuna në familje në fokusin e medias*”, 2008, faqe 13


⁴ <https://www.unicef.org/albania/sq/domviol-alb.pdf>

⁵ Kushtetuta e Shqipërisë, neni 18

⁶ Raporti i Prokurorit të përgjithshëm, 2015, faqe 87

procedime penale që tregojnë për një rritje 4.4% në raport me vitin 2014.⁷ Sipas të dhënave të raportit të Prokurorit të Përgjithshëm, Vlorë është rajoni që ka koeficientin e kriminalitetit më të lartë se të gjitha rajonet e tjera.

Fig. Nr.1, Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë



Burim : Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm, 2015, faqe 38

Në vitin 2014 në prokuroritë e Qarkut Vlorë janë regjistruar 28 vepra penale të dhunës në familje, ndërsa në vitin 2014 janë regjistruar 34. Krahasuar me totalin në shkallë vendi të grupit të veprave penale “vepra penale kundër fëmijëve martesës” rastet e procedimit të dhunës në familje në Qarkun Vlorë përbëjnë 1%.

Nga totali i veprave penale të proceduara në Prokurorinë e Vlorës, dhuna në familje përbën 1,1% të rasteve të procedura nga prokuroria.

3.1.Profili demografik i viktimave të dhunës në familje

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Policisë Vlorë, gjatë vitit 2015 janë evidentuar 96 vepra “Dhunë në familje” sipas nenit 130/a⁸, pasojë e të cilave janë 101 persona të dëmtuar, ndërsa gjatë 2016 janë evidentuar 73 vepra të dhunës në familje, pasojë e së cilës janë regjistruar 81 viktima. Nga 101 persona të dhunës në familje në vitin 2015, vetëm 79 i përkasin gjinisë femërore. Ndër personat e prekur 5 i përkasin grupmoshës 14-18 vjeç. Për sa i përket lidhjes midis viktimës dhe autorit të veprës për veprat e vitit 2015, në 11 raste ka qenë bashkëshorti, 21 raste ish-bashkëshorti, 8 raste prindi, 6 fëmija, ndërsa 25 raste kanë qenë familjarë ose të afërm të tjerë. Për sa i përket lidhjes midis viktimës dhe autorit të veprës për veprat e vitit 2016, në 1 raste ka qenë bashkëshorti, 32 raste ish-bashkëshorti, 14 raste prindi, 7 fëmija,

⁷ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm, 2015, faqe 38

⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

ndërsa 16 raste kanë qenë familjarë ose të afërm të tjerë.

3.2.Profili demografik i dhunuesve

Nga 100 autorë të veprave të dhunës në familje në vitin 2014 në Vlorë, 11% i përkasin gjinisë femërore ndërsa pjesë tjetër 89% gjinisë mashkullore. Për sa i përket strukturës moshore të dhunuesve për regjistrimet e vitit 2015 rezulton si vijon: 1% 14-18 i përkasin grupmoshës vjeç, 7% i përkasin grupmoshës 18-25 vjeç, 25% i përkasin grupmoshës 25-35 vjeç, 22% i përkasin grupmoshës 35- 45 vjeç, 45% i përkasin grupmoshësmbi 45 vjeç. Nga 83 autorë të veprave të dhunës në familje në vitin 2016 në Vlorë, 8.4% i përkasin gjinisë femërore ndërsa pjesë tjetër 91.6% gjinisë mashkullore. Për sa i përket strukturës moshore të dhunuesve për regjistrimet e vitit 2015 rezulton si vijon: 0.01% 14-18 i përkasin grupmoshës vjeç, 9.6% i përkasin grupmoshës 18-25 vjeç, 22.89% i përkasin grupmoshës 25-35 vjeç, 22.89% i përkasin grupmoshës 35-45 vjeç, 43.37% i përkasin grupmoshësmbi 45 vjeç. Sipas strukturës arsimore dhunuesit e vitit 2015 janë: 1 analfabet, 7% me arsim fillor, 61% me arsim 9 vjeçar, 27% me arsim të mesëm, dhe 4 % me arsim të lartë. Sipas strukturës arsimore dhunuesit e vitit 2016 janë: 1.2% analfabet, 4.8% me arsim fillor, 65.06% me arsim 9 vjeçar, 25.03% me arsim të mesëm, dhe 3.6 % me arsim të lartë.

3.3.Ndëshkimi i dhunuesve

Sipas të dhënave për 100 autorë të veprave të dhunës në familje në vitin 2015, 40% janë arrestuar, 7% janë ndaluar, 45% janë në gjendje të lirë, 8% janë shpallur në kërkim. Ndërsa në vitin 2016, nga 83 autorë të veprave të dhunës në familje, 42.16% janë arrestuar, 4.8% janë ndaluar, 50.6% janë në gjendje të lirë, 2.4% janë në kërkim.

4. ANKETË:

Për të marrë një informacion më të plotë lidhur me perceptimin e dhunës në familje, klasifikimin e dhunës dhe shkaqet që e sjellin atë në familje, kemi bërë një anketë ku qytetarë të ndryshëm u kanë dhënë përgjigje disa pyetjeve, të cilën po e trajtojmë më poshtë:

4.1. Perceptimi i dhunës në familje

1. Cilin nga rastet e mëposhtme do të klasifikoni si dhunë në familje?

- Shkaktimi i lëndimeve trupore;
- Marrëdhëniet seksuale apo keqtrajtimi seksual pa pëlqim;
- Shkaktimi i frikës tek tjetri për mirëqenien e vet fizike, emocionale apo ekonomike;
- Rrëmbimi;
- Shkaktimi i dëmeve pasurore;
- Kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së personit jetër;
- Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër;

- Dëbimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët;
- Moslejimi i personit tjetër të hyjë apo të dalë nga banesa e përbashkët;
- Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve të caktuara, me qëllim poshtërimin e personit tjetër;
- Të gjitha;
- Asnjë;
- Tjetër. Specifiko_____.

2. Nëse ju do të ishit viktimë e njërit prej rasteve të mëposhtme cilin prej tyre jeni në gjendje të denonconi në polici?

- Shkaktimi i lëndimeve trupore;
- Marrëdhëniet seksuale apo keqtrajtimi seksual pa pëlqim;
- Shkaktimi i frikës tek tjetri për mirëqenien e vet fizike, emocionale apo ekonomike;
- Rrëmbimi;
- Shkaktimi i dëmeve pasurore;
- Kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së personit tjetër;
- Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër;
- Dëbimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët;
- Moslejimi i personit tjetër të hyjë apo të dalë nga banesa e përbashkët;
- Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve të caktuara, me qëllim poshtërimin e personit tjetër;
- Të gjitha;
- Asnjë;
- Përgjigje tjetër. Specifiko _____.
-

3.Sipas jush cilat janë shkaqet e dhunës në familje?

- Ekonomike (pamjaftueshmëria e të ardhurave financiare);
- Disniveli social dhe kulturor midis partnerëve;
- Tjetër. Specifiko _____.

4.2. Target grup

Anketës i'u nënshtruan 100 gra të moshës 18 - 50 vjeç. 78% e femrave ishin të punësuara, ndërsa 32% ishin të papuna. Theksojmë se, 87.17% e femrave të punësuara (të anketuara) janë me arsim të lartë, ndërsa 12.83% e tyre janë me arsim të mesëm.

4.3. Rezultati

Për pyetjen e parë të pyetësorit rezulton se 81% e femrave cilësojnë si dhunë në familje alternativën e lëndimit fizik ose trupor. Nga këto 81, vetëm 64 prej tyre do të denonconin si dhunë alternativën e dhunës fizike ose lëndimet trupore. Vlen të theksohet se të gjitha gratë e papuna kanë përzgjedhur këtë alternativë çka do të thotë se 50 % e femrave të cilat zgjedhën këtë alternativë ishin të papuna.

Gjithashtu, edhe një tipar tjetër i rezultatit ishte fakti se 82% e femrave përcaktuan si faktor primar për dhunën në familje çështjet ekonomike. Në përgjithësi, në shkallë vendi dhuna në familje ka ardhur në rritje. Është rritur denoncimi nga viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu, ndryshimet e herëpashershme të ligjit kanë sjellë rritjen e sigurisë për viktimat e dhunës në familje duke nxitur denoncimin e dhunuesve. Mundësia e urdhrave të mbrojtjes ka krijuar garanci për shumë viktime të dhunës në familje. Megjithatë krahasuar me të dhënat informate, rastet e dhunës në familje janë shumë herë më të larta se sa ato të denoncuara.

Shumica e viktimave të dhunës në familje I përkasin gjinisë femërore. Shkaku i traditës së trashëguar për perceptimin dhe konceptimin e marrëdhënieve burrë - grua, apo marrëdhënieve brenda familjes bëhen pengesa kryesore e denoncimit të dhunës në familje. Rrënjësia e thellë në historinë e familjes shqiptare sipas modelit patriarkal, bën që shumica e veprimeve të cilat klasifikohen si dhunë në familje sipas definicioneve ligjore të mos bëhet publike, pra të mos denoncohet.

Të dhënat tregojnë se edhe në Rajonin e Vlorës fenomeni i dhunës në familje është prezent. Gjatë viteve të fundit është rritur numri i procedimeve të regjistruara në prokurori, si dhe numri i rasteve të denoncimeve në stacionet policore. Vërehet se ka një rritje të iniciativës së grave për të denoncuar bashkëshortët ose ish-bashkëshortët të cilët ushtrojnë dhunë ndaj tyre.

Fenomeni shqetësues i grupit të veprave penale dhunë ndaj fëmijëve ose ndaj martesës, mbetet edhe dhuna ndaj fëmijëve. Përveç rasteve të cilët janë të regjistruar, shqetësuese janë efektet dhe pasojat që sjellin në të ardhmen për fëmijët, rritja në një familje ku ushtrohet dhunë ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes ose drejtpërdrejtë ndaj fëmijëve. Edhe rezultatet e pyetësorit të zhvilluar, kanë ngjashmëri me shumë pyetësorë të tjerë të realizuar më parë për këtë çështje.

Shqetësuese mbetet fakti që edhe pas kaq shumë kohësh që flitet për dhunën në familje, sërish pjesa më e madhe e femrave priren të cilësojnë si dhunë dhe të jenë të gatshëm të denoncojnë vetëm kur pësojnë lëndime trupore, pra dhunë fizike. Shumica e grave të cilat iu nënshtruan pyetësorit shprehen se shkaku kryesor për dhunën në familje mbetet çështja ekonomike.

Varfëria ose papunësia, sidomos e meshkujve, varësia nga alkooli i meshkujve sjell dhunë në familje. Një numër i vogël i femrave të intervistuar kanë deklaruar se alternativë edhe

disnivelin kulturor. Këto janë përgjithësisht me moshë të re dhe me arsim të lartë universitar, si dhe të punësuar ose në vazhdim të studimeve. Rezultatet tregojnë se pavarësisht ndryshimeve ligjore, ende shumica e femrave ose në përgjithësi shoqëria e trajton si një çështje private dhunën në familje.

Hezitimi për të denoncuar dhunën në familje, është tipari që karakterizon më tepër gjininë femërore. Megjithatë vërehet se gjatë viteve të fundit, rritja e informimit për çështjen e dhunës në familje, rritja e besimit në organet dhe institucionet përkatëse, si dhe përmirësimet e kuadrit ligjor për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje kanë sjellë rritje të rasteve të denoncimeve në polici dhe si rritje të rasteve të procedimeve nga prokuroria.

5. PËRFUNDIME

Në përgjithësi, në shkallë vendi dhuna në familje ka ardhur në rritje. Është rritur denoncimi nga viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu, ndryshimet e herëpashershme të ligjit kanë sjellë rritjen e sigurisë për viktimat e dhunës në familje duke nxitur denoncimin e dhunuesve.

Mundësia e urdhrave të mbrojtjes ka krijuar garanci për shumë viktime të dhunës në familje. Megjithatë krahasuar me të dhënat informate, rastet e dhunës në familje janë shumë herë më të ta larta se sa ato të denoncuar. Shumica e viktimave të dhunës në familje i përkasin gjinisë femërore. Shkaku i traditës së trashëguar për perceptimin dhe konceptimin e marrëdhënieve burrë - grua, apo marrëdhënieve brenda familjes bëhen pengesa kryesore e denoncimit të dhunës në familje.

Rrënjësia e thellë në historinë e familjes shqiptare sipas modelit patriarkal, bën që shumica e veprimeve të cilat klasifikohen si dhunë në familje sipas definicioneve ligjore të mos bëhet publike, pra të mos denoncohet. Të dhënat tregojnë se edhe në Rajonin e Vlorës fenomeni i dhunës në familje është present. Gjatë viteve të fundit është rritur numri i procedimeve të regjistruara në prokurori, si dhe numri i rasteve të denoncimeve në stacionet policore.

Vërehet se ka një rritje të iniciativës së grave për të denoncuar bashkëshortët ose ish-bashkëshortët të cilët ushtrojnë dhunë ndaj tyre. Fenomen shqetësues i grupit të veprave penale dhunë ndaj fëmijëve ose ndaj martesës, mbetet edhe dhuna ndaj fëmijëve. Përveç rasteve të cilët janë të regjistruar, shqetësuese janë efektet dhe pasojat që sjellin në të ardhmen për fëmijët, rritja në një familje ku ushtrohet dhunë ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes ose drejtpërdrejtë ndaj fëmijëve.

Rezultatet e pyetësorit të zhvilluar, kanë ngjashmëri me shumë pyetësorë të tjerë të realizuar më parë për këtë çështje. Shqetësuese mbetet fakti që edhe pas kaq shumë kohësh që flitet për dhunën në familje, sërish pjesa më e madhe e femrave priren të cilësojnë si dhunë dhe të jenë të gatshëm të denoncojnë vetëm kur pësojnë lëndime trupore, pra dhunë fizike. Shumica e grave të cilat iu nënshtruan pyetësorit shprehen se shkaku kryesor për dhunën në familje mbetet çështja ekonomike. Varfëria ose papunësia, sidomos e meshkujve, varësia nga alkooli

i meshkujve sjell dhunë në familje. Një numër i vogël i femrave të intervistuar kanë deklaruar se alternativë edhe disnivelin kulturor. Këto janë përgjithësisht me moshë të re dhe me arsim të lartë universitar, si dhe të punësuar ose në vazhdim të studimeve.

Rezultatet tregojnë se pavarësisht ndryshimeve ligjore, ende shumica e femrave ose në përgjithësi shoqëria e trajton si një çështje private dhunën në familje. Hezitimi për të denoncuar dhunën në familje, është tipari që karakterizon më tepër gjininë femërore.

Megjithatë vërehet se gjatë viteve të fundit, rritja e informimit për çështjen e dhunës në familje, rritja e besimit në organet dhe institucionet përkatëse, si dhe përmirësimet e kuadrit ligjor për t'ndihmuar viktimat e dhunës në familje kanë sjellë rritje të rasteve të denoncimeve në polici dhe si rritje të rasteve të procedimeve nga prokuroria.

6. REFERENCA

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
3. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, I ndryshuar
4. OSCE: Manual, “*Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje*”, 2013
5. Dhuna në familje në Shqipëri: “*Vrojtim kombëtar me bazë popullatën*”, 2013
6. Aleanca Gjinore për Zhvillim “*Dhuna në familje në fokusin e medias*”, 2008
7. Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm, 2015
8. <https://www.unicef.org/albania/sq/domviol-alb.pdf>